

Komuna e Skenderajt 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Komuna e Skenderajt është specifike sa i përket përfaqësimit të saj. Zyrtarisht, Kryetar i Komunës është Sami Lushtaku, por që nga fillimi i mandatit të tij të tretë, më 2013, ai nuk ka arritur ta ushtrojë në mënyre efektive mandatin, shkak i dy proceseve gjyqësore të nisura ndaj tij që lidhen me supozimet e krimeve gjatë luftës (1998-1999). Ai, gjatë muajit qershor 2017, është shpallur i pafajshëm nga gjykata supreme, duke rrezuar kështu vendimet e shkallës së parë dhe të dytë të gjykatës që e gjenin atë fajtor.

Pamundësia e Lushtakut për të ushtruar mandatin ia ka bartur të drejtën nënkryetarit të komunës Fadil Nura që ai të përfaqësojë kryetarin në të gjitha rastet. Lushtaku në zgjedhjet e kaluara (nëntor 2013), ka pasur në Skenderaj 17,825 vota apo 88%, duke e bërë kështu fitues në raundin e parë.¹

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Sipas një studimi të UNDP, 88% e qytetarëve të Skenderajt konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Hulumtimet e opinionit publik nga UNDP tregojnë se 40% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Skenderajt. Ndër problemet më

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2syr1OU> (Qasur më 18.06.2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur më 18.06.2017)

³ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92.

madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes, mungesa e kanalizimit, menaxhimi i mbeturinave, mungesa e lokacionit për varreza, mungesa e transportit për nxënës, mungesa e trotuareve, ndotja e lumit Klina.⁵

Problemet aktuale të Komunës së Skenderajt

Zvarritja e projekteve investuese

Ka disa vite që kanë nisur disa projekte investuese në fshatra dhe vendbanime të Skenderajt, por që dinamika e realizimit të tyre nuk është e kënaqshme. Kësisoj, rregullimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës për në Runik ka ngecur tash e dy vite. Ngjashëm ka ndodhu edhe me instalimin e rrjeti të kanalizimit në një pjesë të fshati Çirez. Po ashtu jo i gjithë qyteti i Skenderajt është i mbuluar me rrejt të ndriçimit publik, në pjesët ku ekziston ky rrjet ka probleme të shpeshta dhe nuk rregullohet për muaj të terë.

Ekzistimi i deponive ilegale të mbeturinave

Në Komunën e Skenderajt ekzistojnë mbi 70 deponi të mbeturinave ku qytetarët hedhin mbetjet e amvisërisë, material ndërtimor e orendi shtëpiake. Kjo gjendje haset në të gjitha vendbanimet e kësaj komune. Deri vone një e tillë ka ekzistuar edhe në zonën urbane të qytetit, përkatësisht në rrugën “Heroinat e Jasharajve”.⁶

Palestra sportive e papërfunduar

Në Komunën e Skenderajt, në vitin 2012, ka nisur së ndërtuari palestra sportive, financim ky i Ministrisë së Kulturës, Rinisë, dhe Sportit në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt. Edhe pesë vjet pas nisjes së punimeve ato nuk kanë përfunduar. Përveç që nuk kanë përfunduar punimet në këtë objekt, edhe punimet e deritanishme të kryera kanë nisur të dëmtohen në disa raste për shkak të papërgjegjësisë së qytetarëve apo nga kushtet klimatike.

Ndotja e lumit Klina

Lumi “Klina”, i cili është lumi i vetëm që kalon nëpër qytetin e Skenderajt po ndotet vazhdimisht nga ujërat e zeza. Mungesa e kanalizimit në këtë komunë ka ndikuar që ujërat e zeza të derdhen në këtë lum, ku masës së ndotjes u shtohet edhe hedhja e

⁵ Instituti GAP, Komuna e Skenderajt: Problemet kryesore dhe trendët buxhetore. Shtator 2013. Burimi: <http://bit.ly/2sE1NPg>

⁶ Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

mbeturinave. Gjatë sezonës së verës, rrjedha e lumit kundërmon erëra të këqija. Ky problem ka qenë evident edhe para zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013.

Mungesa e ujësjellësve në shumë vendbanime

Ky problem ka qenë i listuar në mesin e problemeve të cekura edhe para zgjedhjeve lokale të 2013. Mungesa e ujësjellësit nëpër fshatrat e Komunës së Skenderajt paraqet problem për banorët. Vetëm qyteti i Skenderajt dhe gjashtë fshatra të tjera (Tërnaci, Prekazi, një pjesë e Llaushës, Klinë e Poshtme, Klinë e Mesme dhe Klinë e Epërme) e kanë në dispozicion rrjetin e ujësjellësit. Fshatrat që nuk kanë ujësjellës janë Açarevë, Abri, Turiqevc, Baks, Burojë, Çirez, Çubrel, Dashec, Izbicë, Kotorr, Kryshec, Kuçicë, Leçinë, Makërmal, Marinë, Novosellë, Pemishtë si dhe lagjja "Saraj" në Skenderaj.

Mungesa e kanalizimit

Ngjashëm si me problemin e ujësjellësit, edhe mungesa e kanalizimit përbën shqetësim të madh për banorët e Skenderajt. Përderisa qyteti i Skenderajt, fshati Prekaz dhe një pjesë e Klinës së Poshtme e kanë të rregulluar sistemin e kanalizimit, kjo nuk haset edhe në fshatrat tjera të kësaj ane. Fshatrat të cilat e kanë nivelin më të madh të ndotjes për shkak të mungesës së kanalizimit janë fshatrat Baks, Qirez, Kryshec, bashkësia lokale në Likoc dhe bashkësia lokale në Turiqec.

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Shtrirja e ndriçimit publik

Në Komunën e Skenderajt, përveç qendrës së qytetit, tri rrugëve që lidhen me qendrën si dhe kompleksin memorial "Adem Jashari", zona tjera janë jashtë sistemit të ndriçimit publik. Komuna në katër vitet e ardhshme duhet të shoh si prioritet zgjerimin e këtij rrjeti, veçmas në zonat periferike të qytetit.


Ndërtimi i hapësirave sportive

Komuna e Skenderajt në të gjitha zonat ka mungesa të hapësirave rekreative sportive. Komuna do të duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj sferë dhe në të ardhmen të krijojë kushte për rekreacion dhe sport së paku në zonat kryesore të qytetit.

Trendet buxhetore në Komunën e Skenderajt (2017)

Buxheti i Komunës së Skenderajt për vitin 2017 është 11.9 milion euro.⁷ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 185 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.⁸ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013⁹, që ishte vit zgjedhor, Komuna e Skenderajt ka pasur një rritje të buxhetit prej rreth 2 milionë euro. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Skenderajt 2017



Rritja e buxhetit më 2017, krahasuar me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013), dominohet nga kategoria e pagave me rreth 22% rritje të buxhetit (7.4 milionë euro). Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.¹⁰ Edhe pse rritje të buxhetit ka pësuar edhe kategoria e investimeve kapitale, rreth 20% për dallim nga 2013, pjesëmarrja e kësaj kategorie në buxhetin total të 2017

⁷ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2gNaO2U> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

⁸ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).


* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të ulëta se në 2017 për rreth 30 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKAr1f>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

⁹ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

¹⁰ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

mbetet e njejtë si më 2013 (27%). Njejtë edhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve dhe ajo e shpenzimeve komunale kanë pjesëmarrje të njejtë në buxhetin 2017, rreth 2%, si në atë të 2013.

Figura nr.2: Trendet buxhetore të Skenderajt 2013-2017




Komuna e Skenderajt ka shënuar përparim në vitin 2016 sa i përket të hyrave komunale. Kësisoj janë realizuar 945 mijë euro të hyra, që janë përreth 300 mijë euro me shumë se të hyrat e realizuara nga kjo komunë në vitin 2015.¹¹ Të hyrat nga koncesioni janë shumëfishuar nga viti 2015, ndërsa gati dyfishim të të hyrave kanë pasur kategoria e tatimit në pronë dhe ajo e taksave komunale për leje ndërtimi.¹² Ndërsa kategoritë tjera nuk kanë pasur ndryshime të theksuara për dallim nga 2015.

¹¹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Skenderajt 2016. Burimi: <http://bit.ly/2j5SYNb> (hapur më 6 shtator 2017).

¹² Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Skenderajt. Burimi: <http://bit.ly/1G2fGFI> (hapur më 6 shtator 2017).

Figura nr.3: Të hyrat komunale të Skenderajt, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm


Sipas planifikimeve buxhetore të prezantuara në ligjin për buxhetin 2017¹³, krahasuar me 2017, buxheti i Skenderajt do të ketë rritje prej dy përqind (12.2 milionë euro) më 2018 dhe rreth katër përqind (12.4 milionë euro) më 2019. Rritje më të theksuar të buxhetit më 2018 dhe 2019 do të ketë për sektorin e planifikimit urban dhe mjedisit, ndërsa ulje e theksuar e buxhetit planifikohet të bëhet në sektorin e kadastrës dhe gjeodezisë.

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna duhet t'i largojë deponitë ilegale dhe të sigurojë që ato vende nuk do të rikthehen në deponi.
- Komuna duhet t'i dërgojë kontejnerët e mbeturinave në të gjitha vendbanimet e qytetit.
- Komuna duhet t'i propozojë MKRS marrjen e fondeve për ndërtimin e palestrës sportive.

¹³ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 265.

- 
- Komuna duhet të gjejë fonde për zgjidhjen e problemit nga ujërat e zeza, veçmas derdhjes se këtyre ujerave në lumin e qytetit.
 - Komuna duhet t'i shtojë fondet në kategorinë e investimeve kapitale për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në vendbanime ku mungon rrjeti.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world